REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 111 / 22
Datë/Datum. 28.04.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Psh. nr. 111/22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 108/A, nenin 118 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 10 par 10.1 i "Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave", si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE "Double I & I shpk", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me certifikata për regjistrimin e automjetëve" me numër te prokurimit 214-22-1691-1-1-1, iniciuar nga AK- MPB, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 28 prill 2022, mori këtë:

VENDIM

I. **Hedhet si e pa lejuar (jo e plotë)** ankesa e OE "Double I & I shpk", me nr. të protokolli 111/22, e datës 22 prill 2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me certifikata për regjistrimin e automjetëve" me numër te prokurimit 214-22-1691-1-1-1, iniciuar nga AK- MPB.

II. **I LEJOHET,** autoritetit kontraktues – MPB, që të vazhdoj më tutje me procedurat

e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me certifikata për regjistrimin e automjetëve" me numër te prokurimit 214-22-1691-1-1-1.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në sistemin elektronik me datë 22 prill 2022, ka pranuar ankesë nga OE "Double I & I shpk", për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me certifikata për regjistrimin e automjetëve" me numër te prokurimit 214-22-1691-1-1-1, iniciuar nga AK-MPB.

Operatori ekonomik "Double I & I shpk", me datën 19. 04. 2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në autoritetin kontraktues kundër vendimit të AK-së. Autoriteti kontraktues me datën 21. 04. 2022 ka refuzuar vendimin e operatorit ekonomik ankues, dhe kundër këtij vendimi për refuzim operatori ekonomik me datën 22 prill 2022 në sistemin e e-prokurimit ka parashtruar ankesë në OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas analizimit të lëndës, sqaron se ankesa e operatorit ekonomik ankues është jo e plotë për faktin se OE ankues nuk ka paguar tarifën konform nenit 118 të LPP-së si dhe nuk ka plotësuar formularin e ankesës, ndërkaq nuk është përgjigjur në emailin që OSHP i ka dërguar për plotësim të formularit të ankesës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konsideron se ankesa është e mangët dhe nuk është konform Rregullave për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në OSHP F03, nenit 14 par 2 që thotë se: "*Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me 1% të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 5, 000 euro*".

Duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë, OSHP konstaton se ankesa e parashtruar nga OE ankues, është e pakompletuar andaj edhe e njëjta nuk mund të shqyrtohet.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Z. Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – MPB

1x1 OE-" Double I & I shpk" me seli në Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së